



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202100981/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

**Lënda:** *Rekomandohet përmirësimi i menjëherëshëm i kushteve dhe i trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të IEVP-së Sarandë.*

**Drejtuar:** **Z. Agim ISMAILI**  
Drejtore i Përgjithshëm i Burgjeve

**TIRANË**

**Z. Nasip HOXHA**  
Drejtore i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP)

**SARANDË**

*Të nderuar,*

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 i ligjit nr.81/2020 datë 25.06.2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, kreu një inspektim periodik/vjetor në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Sarandë më datë 01.07.2021, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Ermonela Xhafa, Komisionere e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, z. Hazbi Selita, z. Besnik Deda, dhe znj. Gloria Çarkaxhiu, nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i kushteve të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, garantimi i të drejtave dhe trajtimi i të paraburgosurve në bazë të akteve ligjore e nënligjore dhe dokumenteve ndërkombëtare në fuqi, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Gjatë vizitës monitoruese, grupit të inspektimit iu ofrua mundësia që të kishin akses të plotë në këqyrjen dhe administrimin e dokumentacionit të kërkuar, inspektimin dhe evidentimin e kushteve ku mbahen dhe trajtohen të paraburgosurit në këtë institucion, si dhe zhvillimin e intervistave konfidenciale me personat e paraburgosur, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve në fuqi.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashetrojë gjetjet e këtij inspektimi, si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Inspektimi në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, u zhvillua në kuadër të vizitave periodike monitoruese për vitin 2021, që zhvillon Mekanizmi Kombëtar, në institucionet penitenciare.

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në burgje, grupi i inspektimit u takua me drejtorin e këtij institucioni z. Nasip Hoxha, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, drejtuesi i institucionit informoi për gjendjen e kushteve, në të cilën ndodhen ambientet ku mbahen dhe trajtohen të paraburgosurit në këtë institucion, angazhimin e punonjësve të administratës dhe shërbimit të sigurisë për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të të paraburgosurve në këto ambiente, mënyrën e funksionimit të sistemit të trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave të të paraburgosurve, gjendjen shëndetësore dhe psiko-sociale të të paraburgosurve, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Gjatë takimit me drejtorin e këtij institucioni z.Nasip Hoxha, grupi inspektues kërkoi fillimisht informacion të përgjithshëm në lidhje me respektimin e të drejtave dhe trajtimin e të paraburgosurve nga ana e stafit dhe punonjësve të policisë të këtij institucioni, si dhe mënyrën e trajtimit dhe adresimit të problematikave të ndeshura nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm.

Sa i takon plotësimin të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i datës 17.10.2018, nga informacioni dhe evidentimi në vend i kushteve ku mbahen dhe trajtohen të paraburgosurit, si dhe intervistat konfidenciale të zhvilluara me grupe e individë në këtë institucion, rezultoi:

- **Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi**, për zgjidhjen e situatës së mbipopullimit, sipas ligjit nr.81/2020 datë 25.06.2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Ku çdo paraburgosur i sigurohet shtrat i veçantë dhe një komplet i përshtatshëm fjetjeje. Duke pasur parasysh faktin se ky institucion është vetëm për të paraburgosur dhe lëvizjet mund të jenë të përditëshme popullimi është në kapacitet maksimal të institucionit, ku në muaj e parafundit ka pasur mbi kapacitetin zyrtar.
- **Ishte zbatuar rekomandimi**, për shtimin e nyjeve sanitare, riparimin e plotë të dusheve dhe tualeteve, si dhe përmirësimin e kushteve higjieno sanitare të tyre;
- **Ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e një ambienti të ri me kushte të përshtatshme për ajrimin e të paraburgosurve.

Ndërkohë që një pjesë e rekomandimeve të mëparshme të paraqitura nga Avokati i Popullit nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar sipas informacionit të mbledhur gjatë inspektimit me drejtuesin e institucionit.Konkretisht:

- **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për “Mbylljen e menjëhershme të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, pasi me gjithë rekomandimet e

vazhdueshme të Avokatit të Popullit për kryerjen e rikonstruksionit të plotë të godinës të këtij institucioni, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe ofrimin e shërbimeve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ligjin nr.8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, në këtë institucion vazhdojnë të mbahen dhe trajtohen persona të paraburgosur në kushte jo humane dhe degraduese”, por ishin bërë rikonstrukcion i mjaftushëm për qëndrimin e të paraburgosurve në këtë institucion.

- **Nuk është zbatuar rekomandimi**, për rikonstruksionin e godinës ekzistuese të këtij institucioni, si dhe ambienteve të brendshme të tij, duke parashikuar përshtatjen e dhomave sipas kushteve për jetesë, zgjerimin e dritareve të dhomave për futjen e ajrit dhe dritës natyrale (sipas kritereve teknike të sigurisë), si dhe për eliminimin e lagështirës.
- **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për adresimin dhe zgjidhjen e menjëhershme të çështjes së ambienteve të IEVP Sarandë, i cili shërbente si ambient për dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Sarandë, në përmbushje të Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme, në kushtet kur institucioni funksionon në mbipopullim dhe për mungesë ambienti nuk u ofron dot shërbimet e nevojshme të paraburgosurve të kësaj IEVP-je;
- **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës së dhomës së observim/veçimit, sipas standardeve të vendosura nga kuadri ligjor në fuqi dhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve;
- **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për ndarjen në dhoma më vete sipas kategorive për 18-21 vjeçar, të sëmurë mendorë dhe persona abuzues me substanca narkotike, e parashikuar kjo në nenin 29, pika 1 dhe 2 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve;
- **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm me hapësirë dhe të plotësuar me materialet e nevojshme, i destinuar për ushtrimin e detyrës së specialistëve të sektorit të edukimit;
- **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për kontraktimin e një farmacisti dhe stomatologu me kohë të pjesshme, në mënyrë që të ofrohet një shërbim sa më efikas shëndetësor;
- **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për sigurimin e ilaçeve të të paraburgosurve nga skema e ribursimit duke bërë efektive marrëveshjen tre palëshe midis institucioneve të Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Depos farmaceutike;
- **Nuk ishte zbatuar rekomadimi**, për pajisjen e institucionit me një autoambulancë.

Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë Nr.8927/1, datë 27.09.2018, “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, i ndryshuar, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale IEVP-së Sarandë, është klasifikuar “Institucion Paraburgimi”.

Ky institucion ka një kapacitet maksimal prej **36 personash**. Në ditën e **inspektimit**, në dhomat e banimit në regjimin e brendshëm të institucionit ndodheshin **38 persona**, pra 2 persona të paraburgosur mbi kapacitet zyrtar. Institucioni nuk kishte Sektor të Kujdesit të Veçantë (SKV)

Në lidhje me situatën e popullimit në dhomat e banimit, morëm informacion nga drejtuesit e institucionit edhe për periudhën e fundit 6 mujore. Referuar statistikave të evidentuara nga inspektimi, situatata e popullimit për këtë periudhë paraqitej si më poshtë vijon:

- Janar 35 persona ose 97.2 %
- Shkurt 35 persona ose 97.2 %
- Mars 37 persona ose 102.7 %
- Prill 37 persona ose 102.7%
- Maj 40 persona ose 111%
- Qershor 38 persona ose 105 %

Sikurse paraqitet nga të dhënat e grumbulluara nga inspektimi, situata e popullimit paraqet problematikë pasi për 4 muaj rresht ka pasur numër të shtuar të paraburgosur. Numëri në të vertet është i vogël por në % në muaj maj e qeshor ka qenë edhe 10% më i lartë në lidhje me trajtimin jo dinjitoz të të paraburgosurve, pasi dinamika e të paraburgosurve që akomodohen në këtë institucion ndryshonte herë pas here. Në vlerësimin e standardeve të jetesës së të burgosurve, institucioni i Avokatit të Popullit çmon se mungesa e hapësirës dhe sipërfaqës së nevojshme për jetesë për çdo të burgosur, përbën trajtim jo dinjitoz të tyre dhe duhet të përbëj shqetësim serioz për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (DPB) në vlerësimin e kapaciteteve akomoduese të këtij institucioni dhe shpërndarjen e të burgosurve sipas kapaciteteve të IEVP-ve. Nga vlerësimi i kushteve materiale të institucionit rezulton se, ato nuk janë sipas parametrave teknike jetësore të përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Vlen të theksojmë se Komiteti për Parandalimin e Torturës shprehet se norma minimale e hapësirës për person, në institucione të tilla është 6 m<sup>2</sup>, për dhomat për një person dhe 4 m<sup>2</sup>, kur në to sistemohen më shumë persona. Në këtë normë nuk mbahet parasysh sipërfaqia e tualetit, që mund të ndodhet brenda dhomës. Gjithashtu, sipas standardit të Komitetit për Parandalimin e Torturës, duhet respektuar dhe distanca ndërmjet mureve të dhomave, që duhet të jetë jo më pak se 2 m distancë ndërmjet mureve të dhomës dhe jo më pak se 2.5 m distancë nga dyshemeja me tavanin e dhomës, sikurse përcaktohet dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.<sup>1</sup>

Organika e IEVP, Sarandë ishte e përcaktuar në Urdhërin Nr.43 datë 25.03.2021 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithëshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve në varësi të saj” dhe përbëhej nga 51 punonjës, nga të cilët 10 ishin punonjës civilë dhe 41 ishin punonjës të policisë së burgjeve.

Grupi i inspektimit në vijim të punës, vizitoi mjediset në regjimin e brendshëm të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, u njoh me regjistrat dhe dokumentacionin e disa praktikave që kanë të bëjnë me të drejtat e të burgosurve, si dhe zhvilloi intervista në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit në dhomat e tyre.

## Trajtimi

Grupi i monitorimit, krahas punës për mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve, për identifikimin e rasteve të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative<sup>2</sup>, apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, si edhe të rasteve të marrjes së masave disiplinore, zhvilloi edhe intervista

<sup>1</sup> <sup>1</sup>Vendimi Nr.437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithëshme të Burgjeve”, Neni 30 parashikon se: “Në vendosjen e të paraburgosurve apo të të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo IEVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9m<sup>3</sup> dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4m<sup>2</sup> për çdo person të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar”.

<sup>2</sup> Neni 2, parimet e përgjithshme, Rregullore e Përgjithëshme e Burgjeve.

konfidenciale me të paraburgosurit dhe inspektoi ambientet e brendshme të këtij institucioni. Grupi monitorues, nuk evidentoi raste apo pretendime për tejkalim të forcës fizike nga ana e punonjësve të policisë së burgjeve në këtë I EVP.

Ndërkohë, nga inspektimi ishte evident fakti që, infrastruktura e këtij institucioni kishte përmirësime të kushteve që ofronin, pasi në godinë ishte bërë një investim prej 3.4 milion lekësh, kryesisht në shtrimin e dhomave të regjimit me pllaka, izolimin e ambienteve me qëllim eliminimin në total të lagështirës, ndërtimin e dy tualeteve në fillim të hyrjes së koridorit, të pajisura me dushe dhe të mbajtura pastër në kushte higjeno-sanitare. Ndërtimin e një ambienti të ri me kushte të përshtatshme për ajrimin e të paraburgosurve si dhe ndërtimin e një dhome për takime.

Nga intervistat me të paraburgosurit ata ngritën ankesa që kishin të bënin me hapësirën e vogël të dhomave të banimit, duke patur parasysh faktin që në dhoma ishin të akomoduar 3-4 persona. Hapësirat dhe sipërfaqet e dhomave nuk i përgjigjeshin standartit për normativën që ato duhet të plotësonin për një person, ashtu siç është e sanksionuar në aktet ligjore e nënligjore dhe në aktet ndërkombëtare, për këtë qëllim.

Me tej në intervistat me të paraburgosur rezultoi një numër i madh ankesash, që ishin të lidhura kryesisht me kushtet e përgjithshme të jetesës në institucion si dhe me cilësinë e shërbimeve të kryera nga sektori psiko-social dhe ai shendetësor.

Të paraburgosurit e konsideronin shërbimin e sektorit psiko-social në I EVP Sarandë, jo në nivelin e duhur. Gjithashtu, sipas të paraburgosurve, shërbimi mjekësor në këtë institucion nuk ishte në nivelin e kërkuar dhe nuk ofrohej në cilësi.

Të paraburgosurit, ngritën si shqetësim dhe problematikën e ilaçeve që për efekt shpejtësie duhej t'i siguronin nga familjarët, sikurse nuk kishte as shërbim stomatologjik. Këto shërbime sipas rastit, trajtoheshin në spitalin rajonal të Sarandës.

Gjithashtu, të intervistuarit ngritën si shqetësim larminë e vakteve por jo të cilësisë së gatimit në këtë institucion. Ata pohuan se e konsumonin ushqimin në të tria vaktet.

Ankesat më të shumta që ju paraqitën grupit të inspektimit nga të paraburgosurit, kishin të bënin me pretendimin për vendimet të etiketuara prej tyre si të “padrejta” që marrin organi i prokurorisë dhe gjykatat e rretheve gjyqësore për veprat penale që ju atribuohen, zvarritjen e zbardhjes së vendimeve të gjykatave që shkojnë dhe deri në 6 muaj nga dita e shpalljes së vendimit, mungesën efektive të avokatëve mbrojtës, etj., Por të paraburgosurve nga grupi i inspektimit ju dhanë këshillime ligjore për mënyrën e ndjekjes së këtyre ankesave, pasi nisur nga natyra që ato paraqiten, vlerësohet se objekt i shqyrtimit ligjor nga Mekanizmi Kombëtar dhe Institucioni i Avokatit të Popullit është jashtë kompetecave funksionale.

Të paraburgosurit ngritën si shqetësim mungesën e aktiviteteve me karakter kulturor dhe edukativ, për të cilët institucioni nuk ka ambiente të veçanta për zhvillimin e tyre.

Gjithashtu, një shqetësim i ngritur nga të paraburgosurit ishte mungesa e një njësie tregtare për sigurimin e produkteve bazë dhe të domosdoshme personale. Ata pohuan se ofrimi i

një shërbimi tillë do të jetë një lehtësim për të pasur në çdo kohë produktet bazë të domosdoshme për të jetuar.

Në intervistat konfidenciale me personat e paraburgosur, u ngritën disa ankesa që kishin të bënin me nevojën e një prezence më të madhe të juristit dhe të stafit psiko-social të insitucionit në takimet periodike që zhvillojnë, për dhënien e këshillimeve ligjore dhe sqarimeve të nevojshme në lidhje me të drejtat që iu jep ligji në rastin e kërkesave për transferime dhe lejeve shpërblyese, si dhe nevojën e respektimit të këtyre të drejtave nga ana e stafit dhe punonjësit e policisë të insitucionit.

### **Masat mbrojtëse**

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se, sistemi i kërkesë/ankesave funksiononte normalisht, pasi çdo formular regjistrohej në regjistrin përkatës dhe më tej protokollohej<sup>3</sup>. Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e insitucionit. Të paraburgosurit plotësonin formularin e kërkesë/ankesës dhe e hidhnin në kutinë postare ose ia dorëzonin punonjësit të sektorit psiko-social. Më tej, ato dërgoheshin në sekretarinë e insitucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të insitucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim apo i takonte vetë të paraburgosurit.

Në Insitucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, për shkak të mungesës së infrastrukturës ndarja e të paraburgosurve në seksione të veçanta sipas kategorive 18-21 vjeçar, të sëmurë mendorë dhe persona abuzues me substanca narkotike, të parashikuar në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve<sup>4</sup>, nuk mund të realizohej. Insitucioni kishte vetëm një ambient në regjimin e brendshëm, i cili ishte i ndarë në dhoma dhe jo me seksione. Në momentin e inspektimit nuk kishte persona me probleme të shendetit mendor apo persona abuzues me substanca narkotike. Nga informacioni i drejtuesve të insitucionit, sistemimi i tyre në dhoma të veçanta, ishte e pamundur për shkak të mospërshtatjes dhe familjarizimit që ata kishin me të paraburgosurit e tjerë.

Dhoma e observim/veçimit ndodhej në fund të korridorit të regjimit, por ishte nën administrimin e Komisarariatit të Policisë Sarandë dhe përdorej si dhomë sigurie, sipas një marrëveshje ndërmjet Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme<sup>5</sup>. Grupi i inspektimit, kërkoi gjatë monitorimit në Insitucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë dhe Komisariatin e Policisë Sarandë kopje të kësaj marrëveshjeje, por asnjëri nga këto insitucione nuk e dispononte. Gjendja e dhomës së sigurisë, për sa i përket sipërfaqes dhe kubaturës për një person, ishte në shkelje të kritereve të përcaktuara në aktet normative. Ajo, kishte kushte jo të mira higjieno-sanitare, ku mungonte ndriçimi natyral dhe ajrosja sigurohej nga një dritare shumë e vogël. Kushtet materiale dhe pajisja me orenditë e nevojshme ishin të plotësuara.

Sistemi i monitorimit me kamera në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm ekzistonte dhe ishte funksional. Ato mbanin në vëzhgim mjediset e këtij insitucioni për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë dy javore.

---

<sup>3</sup> Neni 10 i ligjit Nr. 81/2020 dt. 25.06.2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

<sup>4</sup> Neni 29 pika 1 dhe 2, të "Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve".

<sup>5</sup> Marrëveshja dypalëshe mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme "Për mbajtjen dhe trajtimin e përkohshëm të arrestuarve/ndaluarve të komisariateve të policisë Sarandë, Berat, dhe Tropojë në ambientet e IEVP-ve të Ministrisë së Drejtësisë".

Mjediset e përbashkëta që duhet të ofronin arsimim, formim profesional, zhvillim të aftësive individuale, aktivitete sociale, sportive. Mungesa e këtyre ambienteve kishte sjellë pengesa në zhvillimin e aktiviteteve rehabilituese, integruese dhe psiko-sociale.

Në lidhje me takimet me familjarët e të paraburgosurve, nga informacioni i dhënë nga drejtori i institucionit rezultoi se, që nga fillimi i pandemisë takimet fizike me familjarët janë zëvendësuar me takimet online, nëpërmjet platformës Skype, takime që zgjasnin 20 minuta dhe zhvilloheshin 4 herë në muaj. Ndërsa aktivitete fizike të përbashkëta nuk zhvillohen pasi nuk ka ambiente për ti zhvilluar, por është bërë kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për investim dhe krijimin e këtyre ambienteve në IEVP Sarandë. Ndërkohë, janë zhvilluar këshillime individuale dhe është punuar me programe individuale me të paraburgosurit.

Po ashtu, rezultoi se të paraburgosurit zhvillonin një takim fizik me familjarët e tyre, për të cilat nuk kishin ankesa në lidhje me planifikimin dhe kohëzgjatjen e orarit të takimeve.<sup>6</sup>

Komunikimi me telefon me familjet e tyre, të paraburgosurit i zhvillonin normalisht në telefonat me kartë të vendosur në mjediset e korridoreve në regjimin e brendshëm. Ata ishin në gjëndje pune por kishin sinjal të dobët kur ata kryenin telefonatat me familjet dhe të afërmit e tyre. Sa i takon komunikimit me telefon me institucionin e Avokatit të Popullit, të burgosurit ngritën shqetësimin se nuk mund të flisnin lirisht, pasi numrat e telefonit të institucionit nuk ishin të lidhur drejtpërdrejtë pa kartë dhe pa pagesë nga kompania që ofronte këtë shërbim.

Nga komunikimi me drejtorin e institucionit të IEVP Sarandë në lidhje me shqetësimin e ngritur nga të paraburgosurit për sinjalin e dobët të telefonave në kabinat e regjimit të brendshëm të IEVP, u informuam se nuk ka pasur më parë ndonjë kërkesë apo shqetësim të tillë të ngritur nga të paraburgosurit. Gjithashtu, na u premtua se ai do kontaktojë me kompanitë telefonike për të verifikuar pretendimet e ngritura nga të paraburgosurit.

Gjithashtu, në lidhje me sistemin e aparateve të telefonave, ngelet problematik fakti që në sistemin e burgjeve aktualisht operon vetëm një kompani telefonike nga dy kompani që kanë funksionuar rregullisht, gjë e cila ka sjellë për pasojë zvogëlimin e numrit të aparateve në gjëndje pune dhe uljen e minutazhit të kartave telefonike, shqetësim ky i ngritur në intervistat me të burgosurit edhe në IEVP-të e tjera.

Në IEVP Sarandë ishin të punësuar 4 të paraburgosur, nga 6 që ishin të miratuar sipas strukturës organike, në pozicione pune si sanitarë, ndihmës kuzhiner, shpërndarës ushqimi, bojaxhi, lavaxteri etj. Sipas intervistave me të paraburgosurit, punësimi nuk paraqet interesim për sa kohë kushtet e punësimit dhe shpërblimi nuk janë të rregulluar me aktet nënligjore, sikurse parashikohet në nenet 43 dhe 44 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Në kushtet, kur Këshilli i Ministrave ka miratuar së fundmi vendimin për “Për rregullat e posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin

---

<sup>6</sup> Udhëzimi nr.6285/1 datë 14.06.2021 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve “Mbi procedurën e vizitave të të burgosurve me familjarët në kushtet e pandemisë dhe masat parandaluese”.

*për punën e kryer*<sup>7</sup>, është e nevojshme informimi menjëherë i të burgosurve me kriteret, kushtet dhe shpërblimin e punës, me qëllim nxitjen dhe stimulimin e punësimit nga radhët e të dënuarve dhe të paraburgosurve.

### **Kushtet materiale**

Grupi i monitorimit, inspektoi plotësimin e kushteve në ambientet e regjimit të brendshëm të institucionit, sipas kërkesave ligjore dhe në respektim të standardeve më të mira për jetesë dhe aktivitete të të paraburgosurve.

Godina kryesore në regjimin e brendshëm të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, është e organizuar me 1 sektor, pasi godina ishte gjysëm nëntokë dhe përbehej nga 12 dhoma ku secila dhomë kishte 3 deri 4 persona sipas përmasave të dhomave të regjimit. Dhomat ishin të pajisura me orënditë e nevojshme si tavolina, stola dhe raftet për mbajtjen e sendeve personale dhe ruajtjen e ushqimit të të paraburgosurve. Materialet për fjetje si dyshekët, batanijet dhe çarçafët ishin në gjendje të mirë dhe të mirëmbajtura.

Në lidhje me kushtet fizike të dhomave, u konstatua se dritaret e dhomave në njërin krah të regjimit të brendshëm, ishin dritare të vogla e të pamjaftueshme për ajrosje dhe ndriçim natyral. Disa nga dhomat ishin të pajisura me ventilatorë që siguronin qarkullimin e ajrit për të paraburgosurit në këtë institucion. Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte 24 orë dhe përdorej për larjen e trupit dhe pastërtinë higjieno-sanitare të ambienteve, të institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Sarandë. Të paraburgosurit nuk ngritën shqetësim në këtë drejtim.

Ambienti i tualeteve dhe dusheve ishte i plotësuar me pajisjet dhe aksesoret e nevojshëm për plotësimin e nevojave vetjake të higjienës. Dhomat e banimit ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare.

Mjedisi i ajrimit në këtë institucion ishte krijuar në një ambiente të përshtatshëm ku mund të qëndronin deri në 10 -15 persona, ku ishin vendosur 6 stola për uljen e të paraburgosurve gjatë ajrimit, ishte mbuluar dhe hapësira e tij, dhe ajo përmbushte standardet për ajrim. Kërkesat e të paraburgosurve për zhvillimin e aktiviteteve sportive nuk plotësoheshin, pasi mungonin mjediset dhe infrastruktura për zhvillimin e tyre.

Situata ishte shqetësuese, për faktin se në dhomat e të paraburgosurve thuajse mungonte ajrimi dhe drita natyrale, pasi dritaret e dhomave në njërin krah të regjimit ishin shumë të vogla dhe pozicioni i godinës i cili ndodhet gjysmë nën tokë nuk e lejonte hyrjen e mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale

Për larjen e ndërresave të të paraburgosurve, mungonte lavanderia, por si e tillë shërbente një lavatriçe e cila funksiononte dhe ishte e vendosur në hyrje të regjimit të brendshëm. Ajo përdorej vetëm për larjen e ndërresave apo të çarçafëve, por sipas pretendimit të të paraburgosurve ky proces vonohej shumë ndaj ata preferonin që këtë shërbim ta merrnin nga familjet e tyre.

---

<sup>7</sup> Në datë 13.10.2021 u miratua vendimi i KM "Për rregullat e posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin për punën e kryer".



Kuzhina e IEVP-së Sarandë ndodhej në një ambient pranë zyrave të administratës dhe ishte rikonstruktuar dhe pajisur me orenditë e nevojshme. Ajo ishte e pastër dhe e rregullt, e pajisur me frigorifer, bolier dhe aspirator etj. Menyja ditore dhe gramaturat ishin të afishuara në përputhje me rregulloren dhe kampionët ushqimorë ruheshin në kushte frigoriferike, të kyçura me çelës. Në momentin e inspektimit, në institucion nuk kishte persona të cilët të kishin nevojë për dietë ushqimore specifike. Sipas organikës, në këtë institucion punonin 3 (tre) kuzhinierë dhe një i paraburgosur nga lista e të punësuarve. Në kuzhinë ndodhej regjistri i normativave ushqimore. Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menusë së gatimit ishin të sekretuar dhe të protokolluar.

Grupi i inspektimit konstatoi si problematikë kryesore, varësinë e dyfishtë për administrimin e disa ambienteve që ndodheshin në territorin e këtij institucioni, atë të Komisarariatit të Policisë Sarandë dhe Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë. Kjo problematikë reflektohej në mungesën e menaxhimit, të mirëadministrimit dhe përgjegjësisë së këtyre institucioneve për rikonstrukcionin e këtyre ambienteve.

#### **4. Regjimi dhe aktivitetet**

Grupi i inspekitimit u informua lidhur me respektimin e të drejtës të të burgosurve për të patur kontakte me familjarët, në kushtet e masave kufizuese për shkak të COVID-19. Aktualisht, në ambientin e takimeve ishin instaluar 1 kompjuter për lidhje me skype të të paraburgosurve me familjarët e tyre. Biseda online zgjaste deri në 20min, për shkak dhe të fluksit të kërkesave për takim të të paraburgosurve. Grafiku i takimeve me familjarët, firmosej çdo ditë nga drejtori i institucionit. Çdo i burgosur realizonte 4 takime me skype me familjen e tij/në muaj, si dhe kryente 8 biseda telefonike me familjarët/në muaj, sipas përcaktimeve në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Takimet online me familjarët ishin të miratuara nga drejtori dhe shefi i policisë të institucionit, dhe zhvilloheshin sipas orarit të veprimeve, kryesisht vetëm gjatë orëve të paradites. Ndërsa bisedat telefonike, zhvilloheshin gjatë paradites dhe në oraret e mbasdites, sipas kushteve dhe mundësive të familjarëve të të paraburgosurve.

Orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin e pastrimin e dhomave dhe ambientit të përbashkët, punës edukative e profesionale etj.

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, mungonin pothuajse fare aktivitetet sociale dhe rehabilituese, për shkak të mungesës së ambienteve të përbashkëta për kryerjen e tyre. Biblioteka dhe palestara nuk ekzistonte si ambient në këtë institucion. Gjithashtu, nuk kishte as ambiente ku të zhvilloheshin sherbesa fetare apo ushtrimin e riteve.

Trajtimi i të paraburgosurit synon rehabilitimin për riintegrimin e tij në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike. Përgatitja për riintegrim fillon në paraburgim, vazhdon gjatë kryerjes së dënimit dhe pas lirimit nga institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale, në vijim plani individual i trajtimit hartohet nga institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale dhe ofrohet prej tyre ose në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për shërbimet e arsimit, formimit profesional, punësimit dhe organizatat jofitimprurëse. Planin individual i trajtimit mund të ndryshojë duke iu përshtatur përparimit të arritur dhe rrethanave të

tjera. I paraburgosuri inkurajohet që të bashkëpunojë në realizimin e programeve dhe aktiviteteve riedukuese në institucion. <sup>8</sup>

Ndaj, larmia e aktiviteteve që zhvillohen brenda institucionit duhet të jetë e shumëllojtë, ku në to të përfshihen një masë sa më e madhe e të paraburgosurve. Për këtë qëllim, Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se: “Regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror<sup>9</sup>

Pavarësisht kushteve në I EVP Sarandë, Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se, procesi i edukimit, ka një rëndësi të veçantë në rehabilitimin dhe ri-integrimin e personave që vuajnë dënimin në institucionet penitenciare. Ky proces, duhet të përfshijë programet e trajtimit individual, por dhe punën në grupe të të paraburgosurve, duke marrë në konsideratë nevojat individuale psikologjike, shoqërore, moshën, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual ose identitetin gjinor, situatën kulturore dhe ekonomike, mjedisin ku ka jetuar i paraburgosuri dhe i dënuari, veprën penale, si dhe faktorët e riskut. Në këto kushte, në Institucionin e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Sarandë, janë të domosdoshme organizimi i aktiviteteve të përbashkëta kulturore, çlodhëse e sportive me të paraburgosurit. Këto aktivitete, duhet të shërbejnë për motivimin dhe zhvillimin e ndjenjës së përgjegjësisë, rritjen e vetëbesimit, si dhe nxitjen e interesit për arsimim dhe formimin profesional të të paraburgosurve.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të stafit psiko-social, u konstatua se raportet mujore mbi aktivitetin e këtij sektori, dosjet psiko-sociale, si dhe programet individuale të trajtimit, plotësoheshin formalisht, pasi mungesa e ambienteve të përbashkëta e bënte të pamundur realizimin e tyre. Aktivitetet konsistojnë kryesisht në zhvillimin e disa lojrave në tavolinë.

Në lidhje me orarin e ajrimit gjatë muajve të verës nuk kishte ankesa nga të paraburgosurit, ndërsa në stinën e dimrit, me vendosjen e orarit të ri të ajrimit të reduktuar, shumica e të paraburgosurve ishin të pakënaqur. Të paraburgosurit e intervistuar ngritën si ankesë, kthimin në normalitet dhe zhvillimin e sa më shumë aktiviteteve kulturore dhe sportive me pjesëmarrjen e gjerë të të paraburgosurve. Ndërkohë, sipas stafit të institucionit, të paraburgosurit regjistroheshin në disa aktivitete, por jo gjithmonë i frekuentonin ato. Ambienti i ajrimit kishte infrastrukturën e përshtatshme, pasi një pjesë e këtij ambienti ishte mbuluar, kryesisht për rastet kur kushtet atmosferike nuk ishin të favorshme për kryerjen e ajrimit.

Nga inspektimi i dosjeve rezultoi se, ato ishin të plotësuara sipas rubrikave që përmban dosja, kishte të hartuar programe për trajtime individuale, pasqyrim të aktivitete të përbashkëta kryesisht atyre me diskutime në grup për tema sociale, këshillime në ambientet e ajrimit. Sikurse e theksuam edhe më lart, gjatë periudhës së pandemisë kanë munguar aktivitetet e larmishme në bashkëpunim me qendra kulturore apo sportive të

---

<sup>8</sup> Neni 12 pika 1 dhe 2 të ligjit Nr. 81/2020 dt. 25.06.2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

<sup>9</sup>Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

qytetit të Sarandës, takime me shkrimtarë, artistë dhe figura publike të qytetit, të cilat krijojnë atmosferë ndryshe të këta persona dhe ndikojnë në edukimin e tyre.

## 5. Shërbimi shëndetësor

Personeli mjekësor në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, nuk ishte i plotësuar sipas organikës. Organika e stafit mjekësor në këtë institucion përbëhej nga një mjek me kohë të pjesshme nga ora 13:00 deri 16:00 gjatë ditës si dhe në raste urgjente ishte i pranishëm në çdo kohë dhe katër ndihmës mjekë me kohë të plotë. Në organikë mungonin një stomatolog dhe një farmacist.

Mekanizmi Kombëtar konstaton se mungesa e mjekut me kohë të plotë dhe stomatologut ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e stafit, pasi mund të ketë raste urgjente të cilat personeli shëndetësor nuk mund t'i përballojë dhe pasojat mund të jenë të rënda.

Në të njëjtën kohë, fakti që mjeku është i pranishëm në këtë institucion vetëm pjesërisht gjatë ditës dhe më pas, vetëm në kushte të domosdoshmërisë thirret ndihma urgjente mjekësore, shkakton në mënyrë drejtpërdrejtë shkeljen e së drejtës për qasje në shërbimë mjekësor, ku KPT ka rekomanduar se *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet t’u mundësohet qasja te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”*.

Por pavarësisht gjendjes së shërbimit shëndetësor, gjatë vizitës inspektuese në këtë institucion dhe nga intervistat me të paraburgosurit, kishte disa ankesa për sa i përket vonësive për kryerjen e vizitave mjekësore nga mjeku dhe për vizitë tek specialistët e spitalit rajonal Sarandë. Ankesa kishte dhe për mungesën e shërbimit stomatologjik, i cili thuajse nuk funksiononte. Është për tu theksuar se Rregullorja Evropiane e Burgjeve shprehet se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*<sup>10</sup>.

Një problem shqetësues në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë ishte dhe mungesa e një autoambulance, për transportimin në rast emergjence të të sëmurëve për në spitalin rajonal Sarandë. Në këto kushte, nga drejtuesi i institucionit u informuam se, në rastet e emergjencave transporti i të sëmurëve për në spitalin rajonal, kryhej me autoambulancat e shërbimit të urgjencës Sarandë, duke marrë masa shtesë për sigurinë fizike të të paraburgosurve. Ambienti ku kryheshin vizitat mjekësore ishte një mjedis i vogël dhe nuk kishte orenditë e nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi. Dhënia e ilaçeve të paraburgosurve kryhej sipas recetës së firmosur nga mjeku, me ilaçe të furnizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe ilaçe të siguruar nga fondi në dispozicion të këtij institucioni. Skema e rimbursimit të ilaçeve nuk funksiononte për shkak të mungesës së marrëveshjes trepalëshe ndërmjet Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, Fondit të

<sup>10</sup> Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Depos farmaceutike dhe në shumë raste ilaçet siguroheshin nga familjarët e të paraburgosurve.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit të shërbimit shëndetësor, në veçanti të mjekut, u konstatua se regjistri i hapjeve të kartelave, regjistri i shtrimeve në spitalin e qytetit dhe regjistri i vizitave mjekësore të mjekut ishin të sekretuar. Gjithashtu, regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve ishin plotësuar në rregull. Në këtë institucion kishte regjistër për evidentimin e rasteve të dhunës, por nuk kishte të regjistruar asnjë rast dhune.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”.

### **REKOMANDOJMË :**

1. Marrjen e masave të menjëherëshme për rikonstruksionin e plotë të godinës së banimit të të paraburgosurve në I EVP Sarandë për të siguruar ambiente të përshtatëshme dhe dinjitoze, duke parashikuar përshtatjen e dhomave sipas kushteve për jetesë, zgjerimin e dritareve të dhomave për futjen e ajrit dhe dritës natyrale (sipas kriterëve teknike të sigurisë).
2. Marrjen e masave të menjëherëshme për përmirësimin e shërbimeve edukuese.
3. Marrjen e masave për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës së dhomës së observim/veçimit, sipas standardeve të vendosura nga kuadri ligjor në fuqi dhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve.
4. Marrjen e masave për adresimin dhe zgjidhjen e menjëherëshme të çështjes së ambienteve të I EVP Sarandë, i cili shërbente si ambient për dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Sarandë, në përmbushje të Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme, në kushtet kur institucioni funksionon në mbipopullim dhe për mungesë ambienti nuk u ofron dot shërbimet e nevojshme të paraburgosurve të kësaj I EVP-je.
5. Të merren masat të menjëherëshme për akomodimin e personave të moshës 18-21 vjeç në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualët e sigurisë për këtë këtë kategori.
6. Marrjen e masave për krijimin e një ambienti të përshtatshëm me hapësirë dhe të plotësuar me materialet e nevojshme, i destinuar për ushtrimin e detyrës të specialistëve të sektorit të edukimit.

7. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës të stafit mjekësor të institucionit me mjek të përgjithshëm, stomatolog, farmacist, të punësuar me kohë të plotë, në mënyrë që të ofrohet një shërbim sa më efikas shëndetësor.
8. Marrjen e masave urgjente për të krijuar mjaftueshmëri të përshtatur për të ofruar shërbimet shëndetësore në ambientet dhe dhomat shëndetësore ku kryhen shërbimet.
9. Marrjen e masave për sigurimin e ilaçeve të të paraburgosurve nga skema e ribursimit duke bërë efektive marrëveshjen tre palëshe midis institucioneve të Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Depos farmaceutike.
10. Marrjen e masave të nevojshme për hapjen e njësisë tregëtare për ofrimin e produkteve bazë të domosdoshme për të paraburgosurit në IEVP Sarandë.
11. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e cilësisë dhe larmisë së ushqimit.
12. Të merren masa të menjëhershme, për shtimin e operatorëve telefonik dhe vënien në punë të aparateve të telefonave që ndodhen në regjimin e brendshëm, për plotësimin e nevojave të të paraburgosurve për kryerjen e bisedave telefonike me familjarët e tyre, si dhe hapjen e linjës pa shpërblim për numrat e kontaktit me Avokatin e Popullit dhe komunikimin e të burgosurve me institucionin në lidhje me adresimin e ankesave.
13. Të merren masa të menjëhershme për riorganizimin dhe vënien në efikasitet të punës të sektorit psiko-social të institucionit; shtimin e kontakteve të vazhdueshme dhe periodike të stafit psiko-social me të paraburgosurit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi; si dhe nxitjen e organizimit të aktiviteteve edukative e social-kulturore-sportive me të paraburgosurit, duke respektuar masat e parashikuara në protokollin shëndetësor për parandalimin e COVID-19 në institucion.
14. Marrjen e masave për pajisjen e institucionit me një autoambulancë.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONERE**

**ERMONELA XHAFI**